# Porsche Albania Sh.p.k.

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe**
**Pasqyrat Financiare**
**më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Përmbajtja

Faqe


RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR ........ 3

PASQYRA E FITIM HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE ........ 4

PASQYRA E LËVIZJEVE TË KAPITALIT ........ 5

PASQYRA E FLUKSEVE TE PARASË ........ 6

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM ........ 7
2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL ........ 7
3. PËRDORIMI I VLERËSIMIT DHE GJYKIMIT ........ 13
4. ADOPTIMI I STANDARDEVE DHE INTERPRETIMEVE TË REJA APO TË RISHIKUARA ........ 13
5. PËRCAKTIMI I VLERËS SË DREJË ........ 16
6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR ........ 17
7. AKTIVE AFATGJATA JO MATERIALE ........ 21
8. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE ........ 22
9. INVENTARË ........ 24
10. LLOGARITË E ARKËTUESHME ........ 24
11. AKTIVE TË TJERA ........ 25
12. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE TË TYRE ........ 25
13. KAPITALI AKSIONAR ........ 25
14. HUAMARRJET ........ 25
15. PROVIZIONE ........ 25
16. LLOGARITË E PAGUESHME ........ 26
17. DETYRIME TË TJERA ........ 26
18. TË ARDHURAT NGA SHITJET ........ 26
19. KOSTO E MALLRAVE TË SHITUR ........ 26
20. PERSONELI ........ 27
21. FURNIZIME DHE SHËRBIME ........ 27
22. SHPENZIME TË TJERA NETO ........ 27
23. TË ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE ........ 28
24. TATIM FITIMI ........ 28
25. ÇËSHTJET GJYQËSORE ........ 29
26. PALËT E LIDHURA ........ 29
27. NGJARJE TË KUSHTËZUARA DHE ANGAZHIME ........ 31
28. NGJARJET PAS PERIUDHËS RAPORTUESE ........ 31

pwc

# *Raporti i Audituesit të Pavarur*

Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtimit të Porsche Albania shp.k.

## *Opinioni ynë*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Porsche Albania sh.p.k ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2017, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

**Ne kemi audituar:**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përfshijnë:

- pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017;
- pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e lëvizjeve të kapitalit për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

## *Baza për opinionin*

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" në këtë raport.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën e opinionit tonë.

**Pavarësia**

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"), të cilat janë të zbatueshme në auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

## *Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare*

Drejtimi i Shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat Drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

pwc

*Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare*

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga Drejtimi.
- japim përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga Drejtimi dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri të materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që siguron paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k
8 shkurt 2018
Tiranë, Shqipëri

Audituesi ligjor
Jonid Lamllari

# Porsche Albania Sh.p.k.

**Pasqyra e Pozicionit Financiar**

***(shumat në Lekë)***

| | Shënime | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|---|
| **AKTIVET** | | | |
| **Aktive afatgjata** | | | |
| Aktive afatgjata jo materiale | 7 | 36,785,735 | 62,830,488 |
| Aktive afatgjata materiale | 8 | 643,516,899 | 662,007,429 |
| | | 680,302,634 | 724,837,917 |
| **Aktive afatshkurtra** | | | |
| Inventarë | 9 | 634,709,179 | 437,814,268 |
| Llogari të arkëtueshme | 10 | 69,152,428 | 57,173,563 |
| Aktive të tjera | 11 | 34,055,577 | 12,405,443 |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre | 12 | 51,372,970 | 99,593,682 |
| | | 789,290,154 | 606,986,956 |
| **TOTALI I AKTIVEVE** | | 1,469,592,788 | 1,331,824,873 |
| **KAPITALI** | | | |
| Kapitali aksionar | 13 | 707,911,000 | 707,911,000 |
| Fitimi i pashpërndarë | | 72,690,797 | 4,751,237 |
| **TOTALI I KAPITALIT** | | 780,601,797 | 712,662,237 |
| **DETYRIMET** | | | |
| **Detyrimet afatshkurtra:** | | | |
| Huamarrje | 14 | 448,322,676 | 406,043,249 |
| Provigjione | 15 | 34,376,093 | 31,243,735 |
| Llogari të pagueshme | 16 | 144,406,955 | 136,975,091 |
| Tatim fitimi per tu paguar | 24 | 2,377,150 | 5,227,409 |
| Detyrime të tjera | 17 | 59,508,117 | 39,673,152 |
| **TOTALI I DETYRIMEVE** | | 688,990,991 | 619,162,636 |
| **TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT** | | 1,469,592,788 | 1,331,824,873 |

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtorët e Përgjithshëm të Porsche Albania Sh.p.k. më 01 shkurt 2018 dhe janë firmosur nga:

Christoph Erlmoser
**Drejtor i përgjithshëm**

Gentian Bushati
**Drejtor i Përgjithshëm**

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet 7 deri në 31 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e fitim humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse**

*(shumat në Lekë)*

| | Shënime | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017 | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|---|
| Të ardhura nga shitjet | 18 | 2,421,446,073 | 2,199,866,715 |
| Kosto e mallrave të shitur | 19 | (1,979,005,452) | (1,820,823,073) |
| **Fitimi bruto** | | **442,440,621** | **379,043,642** |
| Shpenzimet e personelit | 20 | (144,987,172) | (127,804,665) |
| Shpenzime për furnitorët dhe shërbime | 21 | (152,791,011) | (145,485,520) |
| Zhvlerësimi dhe Amortizimi | 7,8 | (50,834,053) | (49,166,934) |
| Shpenzime/Të ardhura të tjera neto | 22 | (9,122,732) | (109,947,668) |
| **Fitimi/(humbja) operative** | | **84,705,654** | **(53,361,145)** |
| Shpenzime financiare | | (7,681,199) | (8,715,524) |
| Të ardhura financiare | | 9,604,888 | 9,241,191 |
| **Shpenzime neto financiare** | 23 | 1,923,689 | **525,667** |
| **Fitimi/(Humbja) para tatimit** | | **86,629,343** | **(52,835,478)** |
| Tatimi mbi fitimin | 24 | (18,689,783) | (15,129,389) |
| **Fitimi/(Humbja) i vitit** | | **67,939,560** | **(67,964,867)** |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse | | - | - |
| **Totali i të ardhurave/(humbje) gjithëpërfshirëse** | | 67,939,560 | (67,964,867) |

Pasqyra e fitim humbjes dhe e te ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet 7 deri në 31 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e lëvizjeve të kapitalit**
*(shumat në Lekë)*

| | Kapitali aksionar | Fitimi i pashpërndarë | Totali |
|---|---|---|---|
| **Teprica më 1 janar 2016** | **707,911,000** | **72,716,104** | **780,627,104** |
| Humbja e vitit | - | (67,964,867) | (67,964,867) |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse | - | - | - |
| **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse** | **-** | **(67,964,867)** | **(67,964,867)** |
| **Teprica më 31 dhjetor 2016** | **707,911,000** | **4,751,237** | **712,662,237** |
| Fitimi i vitit | - | 67,939,560 | 67,939,560 |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse | - | - | - |
| **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse** | **-** | **67,939,560** | **67,939,560** |
| **Teprica më 31 dhjetor 2017** | **707,911,000** | **72,690,797** | **780,601,797** |

Pasqyra e lëvizjeve të kapitalit duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet 7 deri në 31 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# Porsche Albania Sh.p.k.

**Pasqyra e flukseve te parasë**
***(shumat në Lekë)***

| | Shëni me | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017 | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|---|
| **Fluksi i parasë nga aktivitetet operative** | | | |
| Fitimi i vitit | | **67,939,560** | **9,632,837** |
| *Rregullime për:* | | | |
| Zhvlerësimin dhe amortizimin | 7,8 | 50,834,053 | 49,166,934 |
| Zhvlerësim i tokës | 22 | - | 108,184,000 |
| Fitimi nga shitja e aktiveve afatgjata | 22 | (423,879) | (181,575) |
| Zhvlerësimi i inventarit në vlerën neto të realizueshme | 19 | (550,821) | 5,839,599 |
| Të ardhura nga interesi | 23 | - | (27,658) |
| Shpenzime interesi | 23 | 5,530,504 | 6,647,482 |
| Shpenzim tatim fitimi | 24 | 18,689,783 | 15,129,389 |
| **Fluksi i mjeteve monetare nga fitimet operative para ndryshimeve në kapitalin qarkullues** | | **142,019,200** | **116,793,303** |
| Rritje në llogaritë e arkëtueshme | | (11,978.,65) | (15,674,190) |
| Rritje në aktive të tjera | | (21,650,133) | (1,645,612) |
| Rritje në inventar | | (196,344,090) | (39,217,019) |
| Rënie/(rritje) në llogaritë e pagueshme | | 7,431,865 | (8,148,219) |
| Rritje në provizione | | 3,132,358 | 21,163,575 |
| Rënie/(rritje) në detyrime të tjera | | 19,834,965 | (707,001) |
| **Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative** | | **(57,554,701)** | **72,564,837** |
| Tatim fitimi i paguar | | (21,540,042) | (8,577,003) |
| Interesa të paguara | | (5,530,504) | (6,647,482) |
| Interesa të arkëtuar | | - | 27,658 |
| **Flukse monetare neto të gjeneruara nga aktivitetet operative** | | **(84,625,247)** | **57,368,010** |
| **Flukset monetare nga aktivitetet investuese** | | | |
| Blerje e aktiveve të qëndrueshme | 8 | (7,863,963) | (28,218,776) |
| Të ardhura nga shitja e aktiveve të Shoqërisë | | 1,989,072 | 185,325 |
| Blerje e aktiveve jo materiale | 7 | - | (76,835) |
| **Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese** | | **(5,874,891)** | **(28,110,286)** |
| **Flukset monetare nga aktivitetet financuese** | | | |
| Shtimi i huave | | 42,279,427 | 11,805,512 |
| **Flukset monetare neto të gjeneruara/ (përdorura në) nga aktivitetet financuese** | | **42,279,427** | **11,805,512** |
| **Rritje neto në mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre** | | (48,220,711) | 41,063,236 |
| **Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre më 1 janar** | 12 | 99,593,681 | 58,530,445 |
| **Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre më 31 dhjetor** | 12 | **51,372,970** | **99,593,681** |

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet 7 deri në 31 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## 1. Informacion i përgjithshëm

Porsche Albania Sh.p.k. ("Shoqëria") është e themeluar dhe e vendosur në Shqipëri. Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas vendimit të gjykatës nr. 33732, datë 27 qershor 2005 në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, Shoqëria Mëmë e Porsche Albania sh.p.k. me kontroll të drejtpëdrejtë është Porsche Holding GmbH, dhe kontrollohet në mënyrë përfundimtare nga Volkswagen AG.

***Aktiviteti kryesor:*** Shoqëria nisi aktivitetin e saj në gusht të vitit 2005. Aktiviteti kryesor i saj është shitja me pakicë dhe shumicë e automjeteve për pasagjerë dhe e pjesëve të këmbimit.

***Adresa e regjistruar dhe vendi i biznesit:*** Adresa e regjistruar e Shoqërisë është: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 3 Mëzez. Në 2015, Shoqëria ka regjistruar një adresë sekondare të ushtrimit të aktivitetit: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 7, Kashar. Shoqëria Mëmë është e regjistruar në Salzburg, Austri.

## 2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

### Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe në bazë të kostos historike. Politikat kontabël të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare shpjegohen më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveçse kur është përcaktuar ndryshe (referohu Shënimit shpjegues 4 për standardet e reja dhe të rishikuara të përdorura nga Shoqëria).

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon përdorimin e disa vlerësimeve dhe gjykimeve kontabël të veçanta. Kërkohet gjithashtu që menaxhimi të ushtrojë gjykimin e tij gjatë proçesit të aplikimit të politikave kontabël të grupit. Rastet kur kërkohet një nivel më i lartë gjykimi apo kompleksiteti, ose kur supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare, shpjegohen në Shënimet shpjeguese 3.

### Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë Shqiptar, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

### (a) Aktivet afatgjata materiale

*(i) Njohja dhe matja*

Zërat që përfshihen në Aktivet afatgjata materiale janë të shprehur me kosto të pakësuar me zhvlerësimin e akumuluar (shih më poshtë) dhe humbjet nga zhvlerësimi (shih politikën kontabël 2(e)(ii)).

Kosto përfshin shpenzimet që janë të lidhura drejtpërdrejt me koston e blerjes së aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, dhe çdo kosto tjetër drejtpërsëdrejti të lidhur me sjelljen e aktivit në gjendjen e tij të parashikuar për punë.

Kur pjesët e një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato konsiderohen si elementë të veçantë (komponentë kryesorë).

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të një aktivi afatgjatë material përcaktohen duke krahasuar të ardhurat e gjeneruara nga shitja me vlerën e mbetur të tyre, dhe njihen neto brenda të ardhurave/shpenzimeve të tjera në pasqyrën e të ardhura dhe shpenzimeve.

Shoqëria dhe kostot e saj mund të maten në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim apo humbje në momentin kur ndodhin

**2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**a) Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)**

*(ii) Kosto të mëtejshme*

Kosto e zëvendësimit të një aktivi afatgjatë material njihet në vlerën e mbetur të aktivit nëse pritet që prej këtij zëvendësimi të rrjedhin përfitime të ardhshme ekonomike për Shoqërinë dhe nëse kjo kosto mund të matet në mënyrë të besueshme.

*(iii) Zhvlerësimi*

Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale realizohet përmes metodës lineare sipas normave që përafrohen me jetën e dobishme ekonomike. Toka nuk zhvlerësohet. Normat e përcaktuara të zhvlerësimit ishin si më poshtë:

| | |
|---|---|
| Ndërtesa | 4% |
| Makineri dhe pajisje | 10-20% |
| Pajisje të përpunimit elektronik të dhënave | 33% |
| Mobilje dhe pajisje zyre | 20% |
| Mjete transporti | 20% |

**(b) Aktivet afatgjata jo materiale**

Aktivet afatgjata jo materiale të blera nga Shoqëria njihen me kosto duke hequr zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi (nëse ka). Amortizimi njihet në fitim apo humbje mbi bazë lineare mbi jetën e vlerësuar të aktiveve afatgjata jo materiale nga data në të cilën ato janë në gjendjen e parashikuar për punë. Normat vjetore të amortizimit janë si vijon:

| | |
|---|---|
| Programe kompjuterike | 33% |
| Të drejta mbi ekskluzivitetin e distribucionit | 15% |

**(c) Inventarë**

Inventarët maten me vlerën më të ulët ndërmjet kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarit bazohet në metodën e identifikimit specifik dhe përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e konvertimit dhe të gjitha kostot e ndodhura për të sjellë inventarët në vendndodhjen dhe gjendjen e tyre aktuale. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i vlerësuar gjatë rrjedhës normale të biznesit duke hequr kostot e vlerësuara të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes. Shoqëria vlerëson në fund të çdo periudhe raportuese nëse vlera e mbartur e inventarëve të saj është e rekuperueshme në rast dëmtimi, vjetrimi, qarkullimi të ngadaltë dhe / ose rënie të çmimit. Nëse një mall ose grup mallrash zhvlerësohet, Shoqëria njeh një humbje nga zhvlerësimi.

**(d) Instrumente Financiare**

Shoqëria mban vetëm instrumente financiare jo derivative.

*(i) Aktive financiare jo derivative*

Aktivet financiare jo derivative përfshijnë mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera. Shoqëria i klasifikon aktivet financiare jo derivative në kategorinë "Hua dhe të arkëtueshme".

Shoqëria i njeh llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe depozitat në datën në të cilën janë krijuar. Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar janë transferuar. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.
Aktivet dhe detyrimet financiare mund të kompensohen dhe shuma neto e tyre të paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur, Shoqëria ka të drejtë ligjore për të kompensuar shumat dhe synon ose të shlyejë mbi një bazë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrim në të njëjtën kohë.

**2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(d).Instrumente financiare (vazhdim )**

*(ii) Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera*

Llogaritë e arkëtueshme njihen në momentin fillestar me vlerën e drejtë të tyre dhe më pas mbarten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*(iii) Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre.*

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë gjendjen në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak, të cilat janë subjekt i rrezikut të parëndësishëm të ndryshimit të vlerës së drejtë të tyre dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

*(iv) Detyrime financiare jo derivative*

Detyrimet financiare jo derivative përfshijnë huamarrjet dhe llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera. Shoqëria i klasifikon detyrimet financiare jo derivative në kategorinë "Detyrime të tjera financiare". Shoqëria fillimisht i njeh llogaritë e pagueshme në datën në të cilën janë krijuar. Shoqëria e çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shlyhen, anullohen apo i përfundon afati. Këto detyrime financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni të lidhur drejtpërdrejt me detyrimin.

Pas njohjes fillestare, këto detyrime financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kontabilizimi për të ardhurat dhe shpenzimet financiare gjendet në politikën kontabël 2 (j).

*(v) Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet me vlerë nominale.

**(e) Zhvlerësimi**

*(i) Aktive financiare*

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitimin apo humbjen e periudhës kur shkaktohen si rezultat i një ose disa ngjarjeve ("ngjarje të humbjes"), të cilat ndodhin pas njohjes fillestare të aktivit financiar dhe kanë një ndikim në vlerën apo kohën e flukseve të ardhshme monetare të aktivit financiar ose grupit të aktiveve financiare që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Nëse Shoqëria përcakton se asnjë provë objektive nuk ekziston që zhvlerësimi shkaktohet për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, pavarësisht nëse është i rëndësishëm ose jo, ajo e përfshin aktivin në një grup aktivesh financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë, dhe i vlerëson në mënyrë kolektive për zhvlerësimin e tyre.

Faktorët kryesorë të cilët merr në konsideratë Shoqëria për të përcaktuar nëse një aktiv financiar është i zhvlerësuar, janë statusi i tij në vonesë dhe realizueshmëria e kolateralit përkatës, nëse ka ndonjë.

Kriteret e mëposhtme përdoren gjithashtu për të përcaktuar nëse ka të dhëna të mjaftueshme që zhvlerësimi ka ndodhur:

- çdo pjesë apo këst që është vonuar dhe pagesa e vonuar nuk mund ti atribuohet një vonese që shkaktohet nga sistemet;
- pala tjetër përjeton vështirësi financiare sikurse evidentohet nga informacioni financiar që Shoqëria siguron;
- pala tjetër merr në konsideratë falimentimin ose një riorganizim financiar;
- ka një ndryshim të pafavorshëm në statusin pagues të palës tjetër si rezultat i ndryshimeve në gjendjen kombëtare ose vendore ekonomike që ndikojnë palën; ose
- vlera e kolateralit, nëse ka, zvogëlohet si pasojë e përkeqësimit të kushteve të tregut.

**2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(e) Zhvlerësimi (vazhdim)**

***(i) Aktive financiare* (vazhdim)**

Për qëllim të një vlerësimi kolektiv të zhvlerësimit, aktivet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të njëjta të rrezikut të kredisë. Këto karakteristika janë të rëndësishme për vlerësimin e flukseve monetare të ardhshme duke shërbyer si tregues i aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumat në përputhje me kushtet kontraktuale të aktiveve që po vlerësohen.
Flukset monetare të ardhshme të aktiveve financiare që vlerësohen në mënyrë kolektive për zhvlerësim, vlerësohen në bazë të flukseve monetare kontraktuale të aktiveve dhe eksperiencës së menaxhimit në lidhje me masën në të cilën pagesat do të prapambeten si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe suksesit të rimarrjes së shumave të prapambetura. Eksperiencat e kaluara rregullohen në bazë të dhënave aktuale për të reflektuar efektet e kushteve aktuale që nuk prekin periudhat e kaluara dhe për të eliminuar efektet e kushteve të kaluara që nuk ekzistojnë më.

Nëse kushtet e një aktivi financiar të zhvlerësuar, të mbajtur me kosto të amortizuar tregtohen serish ose modifikohen për shkak të vështirësive financiare të palës tjetër, zhvlerësimi matet duke përdorur normën efektive të interesit përpara modifikimit të kushteve. Aktivi i ritregtuar çregjistrohet dhe një aktiv i ri do të njihet me vlerën e tij të drejtë vetëm nëse rreziqet dhe përfitimet e aktivit ndryshojnë thelbësisht. Kjo evidentohet nga një diferencë thelbësore ndërmjet vlerës aktuale të flukseve monetare origjinale dhe flukseve të reja të pritshme.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen nëpërmjet një llogarie zbritjeje për të sjellë vlerën e mbartur të aktivit në vlerën aktuale të flukseve monetare të pritshme (të cilat nuk përfshijnë humbjet e ardhshme që nuk kanë ndodhur), të aktualizuara me normën efektive të interesit të aktivit. Llogaritja e vlerës aktuale të flukseve monetare të vlerësuara të një aktivi financiar të vendosur si kolateral, pasqyron flukset monetare që mund të rezultojnë nga marrja nën zotërim e aktivit minus kostos për marrjen dhe shitjen e tij, pavarësisht nëse marrja nën zotërim është e mundshme ose jo. Nëse, në një periudhë të mëvonshme, vlera e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi lidhet me një ngjarje që ndodh pas njohjes së zhvlerësimit, ( si p.sh. një përmirësim në vlerësimin e kreditit të debitorit), humbja e zhvlerësimit e njohur më parë anullohet duke rregulluar llogarinë e zbritjes përmes fitimit ose humbjes për vitin.

Aktivet e pambledhshme anullohen nëpërmjet provizionit për humbjet nga zhvlerësimi, pasi të gjitha procedurat e nevojshme për të rikuperuar aktivin janë ndjekur dhe vlera e humbjes është përcaktuar. Rikuperimet pasuese të shumave të zbritura më parë kreditohen në llogarinë humbje nga zhvlerësimi në kuadër të fitimit ose humbjes për vitin.

***(ii) Aktive jo financiare***

Vlera e mbartur e aktiveve jo financiare të Shoqërise, përveç inventarëve dhe tatimit të shtyrë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka zhvlerësim. Nëse ekziston një tregues i tillë, atëherë vlera e rekuperueshme e aktivit vlerësohet. Njihet një humbje nga zhvlerësimi, nëse vlera e mbartur e një aktivi ose njësie që gjeneron para e tejkalon vlerën e saj të rekuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave apo shpenzimeve.

Një njësi gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare, që janë të pavarura nga aktive të tjera. Vlera e rekuperueshme e një aktivi apo njësie gjeneruese të parasë është më e madhja ndërmjet vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Për të përcaktuar vlerën në përdorim, fluksеt monetare të ardhshme të vlerësuara skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi përpara tatimit, e cila pasqyron vlerësimet aktuale të tregut dhe rreziqet specifike të aktivit.

**2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(e) Zhvlerësimi (vazhdim)**

***(ii) Aktive jo financiare (vazhdim)***

Në lidhje me aktive të tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka ndonjë tregues që humbja nga zhvlerësimi nuk ekziston më dhe ka ndodhur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi kthehet vetëm në masën, me të cilën vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën e mbetur te tij e cila do ishte përcaktuar si vlera neto pas zhvlerësimit apo amortizimit nëse nuk do ishte njohur humbja nga rënia në vlerë.

**(f) Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat nga shitja e mallrave gjatë zhvillimit të aktivitetit normal njihen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, neto nga zbritjet apo tatimet mbi shitjet. Të ardhurat njihen kur rreziqet e rëndësishme dhe përfitimet që lidhen me pronësinë i janë transferuar blerësit, rikuperimi i shumave është i mundur, kostot e lidhura dhe kthimi i mundshëm i mallrave mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, nuk ka përfshirje të vazhdueshme të menaxhimit me mallrat dhe vlera e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme.

Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në proporcion me fazën e përfundimit të transaksionit në datën e raportimit.

Për të ardhurat nga qiraja operative referohuni tek politika 2 (g).

Shoqëria ka një detyrim ligjor lidhur me garancinë për automjetet e reja, me të drejtën për të kërkuar ndaj prodhuesit çdo shërbim të kryer lidhur më garancitë. Njihet e njëjta vlerë e të ardhurave nga garancia në momentin kur shpenzimet për garancinë ndodhin.

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 nuk ka garanci përtej kushteve të prodhuesit.

**(g) Qira operative**

Kur Shoqëria është qiramarrëse në një marrëveshje qiraje e cila nuk i transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë nga qiradhënësi drejt Shoqërisë, totali i pagesave të qirasë i ngarkohet fitimit ose humbjes për vitin në baza lineare përgjatë afatit të qirasë. Afati i qirasë është periudha e paanullueshme për të cilën qiramarrësi ka kontraktuar për të marrë me qira aktivin, duke përfshirë çdo kusht tjetër për të cilin qiramarrësi ka mundësinë për të vazhduar të marrë me qira aktivin, me ose pa pagesë të mëtejshme, kur në fillim të qirasë është e sigurtë se qiramarrësi do ta ushtrojë këtë opsion. Kur aktivet jepen me qira nën një kontratë qiraje operative, pagesat e qirasë njihen si të ardhura nga qiraja mbi një bazë lineare përgjatë afatit të qirasë.

**(h) Përfitimet e punonjësve**

*(i) Sigurimet shoqërore të detyrueshme*

Shoqëria derdh vetëm kontribute shoqërore të detyrueshme që ofrojnë përfitime të pensionit për punonjësit mbas daljes në pension. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për ofrimin e kufirit minimum ligjor për pensionet në Shqipëri sipas një plani të përcaktuar të derdhjes së kontributeve. Kontributet që derdh Shoqëria njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin që ndodhin.

*(ii) Leja vjetore e paguar*

Shoqëria njeh si detyrim vlerën e paaktualizuar të kostove të vlerësuara të lidhura me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimeve të punonjësve për periudhën e përfunduar.

**2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(i) Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim aktual ose konstruktiv ligjor që mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke aktualizuar flukset e ardhshme të parasë me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Aktualizimet e dhëna do të njihen si kosto financiare.

**(j) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi mbi balancat në banka. Të ardhurat nga interesi njihen në baza rritëse, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit mbi huamarrjet. Kostot e huamarrjes që nuk i atribuohen në mënyrë direkte blerjes, ndërtimit apo prodhimit të një aktivi do të njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit raportohen në bazë neto ose si të ardhura financiare ose si kosto financiare në varësi të faktit nëse lëvizjet e kursit të këmbimit janë në një pozicion humbje apo fitimi neto.

**(k)Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me normën e këmbimit të datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj, në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit të asaj date. Humbja ose fitimi nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe koston e amortizuar në monedhë të huaj e përkthyer sipas kursit të këmbimit në fund të periudhës. Diferencat që lindin nga kursi i këmbimit nga ripërkthimi do të njihen si fitim ose humbje.

**(l) Tatim fitimi**

Shpenzimet e tatim fitimit përfshijnë tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Këto shpenzime njihen në fitime ose humbje me përjashtim të rasteve kur njohja bëhet direkt në kapital apo në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurën e tatueshme të vitit, duke përdorur normat në fuqi apo kryesisht në fuqi në datën e raportimit, si dhe çdo rregullim për tatimin e pagueshëm të viteve të mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet për diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë llogaritet përmes normave tatimore që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të rikthehen mbrapsht, bazuar në ligjet që janë në fuqi apo kryesisht në fuqi në datën e raportimit.

Aktivet dhe detyrimet e shtyra tatimore kompensohen nëse ekziston një e drejtë ligjërisht e zbatueshme për të kompensuar aktivet dhe detyrimet tatimore aktuale dhe ato lidhen me tatimet mbi të ardhurat e mbledhura nga i njëjti autoritet tatimor.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën në të cilën është e mundur të ketë fitime të ardhshme të tatueshme përkundrejt të cilave të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në shkallën në të cilën nuk është më e mundur që përfitimi tatimor përkatës të mund të realizohet.

### 3. Përdorimi i vlerësimit dhe gjykimit

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon nga menaxhimit që të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë aplikimin e politikave dhe vlerave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacioni për raste të rëndësishme të pasigurisë në vlerësimin dhe gjykimin kritik për aplikimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, përfshihet në shënimet shpjeguese të mëposhtme:

- Shënimi 10 dhe 2(e) (i) – Instrumentet financiare (Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme)
- Shënimi 9 dhe 2(c) – Inventari (Zvogëlimi në vlerën neto të realizueshme)
- Shënimi 15 – Provizionet

### 4. Adoptimi i Standardeve dhe interpretimeve të reja apo të rishikuara

Standardet dhe interpretimet reja efektive për Shoqërinë nga 1 janar 2017 janë si me poshtë:

***Iniciativa për dhënien e informacioneve shpjeguese - Ndryshime në SNK 7 (lëshuar më 29 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2017)*** SNK 7 i ndryshuar do të kërkojë paraqitjen e një rakordimi në lidhje me lëvizjet që rrjedhin nga aktivitetet e financimit.

***Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e parealizuara - Ndryshimet në SNK 12***

Ndryshimet kanë sqaruar tatimin mbi të ardhurat në aspektet e mëposhtme:

- Humbjet e parealizuara mbi instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë dhe të matura me kosto për qëllime tatimore japin një diferencë të përkohshme të zbritshme pavarësisht nëse mbajtësi i instrumentit të borxhit pret të rimarrë vlerën kontabël të instrumentit të borxhit me shitje ose me përdorim.

- Vlera kontabël e një aktivi nuk kufizon vlerësimin e fitimeve të mundshme të ardhshme të tatueshme.

- Vlerësimet për fitimet e tatueshme të ardhshme përjashtojnë zbritjet tatimore që rezultojnë nga anullimi i diferencave të përkohshme të zbritshme.

- Një njësi ekonomike vlerëson një aktiv tatimor të shtyrë në kombinim me aktivet e tjera tatimore të shtyra. Kur ligji tatimor kufizon shfrytëzimin e humbjeve tatimore, një njësi ekonomike do të vlerësonte një aktiv tatimor të shtyrë në kombinim me aktivet tatimore të shtyra të të njëjtit lloj.

Standardi i rishikuar nuk kishte një ndikim material mbi Shoqërinë.

***Ndryshime në SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klientët***

Ndryshimi pritet të qartësojë tri aspekte të standardit (identifikimi i detyrimeve të performancës, principali kundrejt konsideratave të agjentëve dhe licencimit) dhe për të siguruar një lehtësim tranzitor për kontratat e modifikuara dhe kontratat e përfunduara. Standardi i rishikuar nuk kishte një ndikim material mbi Shoqërinë.

**4. Adoptimi i Standardeve dhe interpretimeve të reja apo të rishikuara (vazhdim)**

***Ndryshime në SNRF 2, Pagesa të bazuara në aksione***

Ndryshimet ne SNRF 2 qartësojnë kontabilitetin e transaksioneve për pagesa të bazuara në aksione të shlyera në mjete monetare te cilat përmbajne kushte për performancën, klasifikimin për pagesa të bazuara në aksione me karakterisika të shlyerjes neto, dhe për kontabilizimin e modifikimeve të pagesave të bazuara në aksione nga pagesa në mjete monetare në pagesa në kapital. Standardi i rishikuar nuk kishte një ndikim material mbi Shoqërinë.

***Përmirësimet vjetore në SNRF-të, cikli 2014-2016. Ndryshimet për standartet e mëposhtme:***

- **SNRF 1** - U ndryshua dhe u hoqën disa nga përjashtimet afatshkurtra ne paragrafet E3 – E7 nga SNRF 1, pasi këto përjashtime afatshkurtra e kishin arritur qëllimin e tyre.

- **SNRF 12** - Ndryshimet qartësojnë qëllimin e standardit duke specifikuar se kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese në standard,, përveç atyre që ndodhen në paragrafet B10 - B16, zbatohen për interesat e një njësie te listuar në paragrafin 5 të cilat klasifikohen si të mbajtura për shitje ose për veprimtari të ndërprera, në përputhje me SNRF 5. Aktivet Afatgjata të mbajtura për shitje ose për veprimtari të ndërprera.

- **SNK 28** – Qartëson se një njësi duhet të masë me vlëren e drejte nëpërmjet fitimit dhe humbjes investimet në filiale ose sipërmarrje të përbashkët të cilat i përkasin një njësie ekonomike e cila është një organizatë kapitale, ose një subjekt tjetër kualifikues, është i disponueshëm për çdo investim në një shoqëri ose sipërmarrje të përbashkët mbi një bazë të investimeve për investime, pas njohjes fillestare. Standardi i rishikuar nuk kishte një ndikim material mbi Shoqërinë.

***Transferimet e Aktiveve Afatgjata Materiale të Investuara – (Ndryshime në SNK 40).*** Ndryshimi në paragrafin 57, specifikon se një njësi duhet të transferojë aktivet afatgjata vetëm nëse ka pasur evidence për një ndryshim në përdorimin e aktivit Një ndryshim përdorimi ndodh nëse prona përmbush ose pushon së përmbushuri, përkufizimin e pronës së investimit. Një ndryshim në qëllimet e menaxhimit për përdorimin e një aktivi afatgjatë në vetvete nuk përbën evidence per ndryshim në përdorim. Lista e shëmbujve të evidencave të paraqitura në paragrafet 57(a) – (d) tashmë është paraqitur si një listë jo e plotë shembujsh në vënd të listës së plotë të meparshme. Standardi i rishikuar nuk kishte një ndikim material mbi Shoqërinë.

Standartet e reja dhe interpretimet e lëshuara janë të detyrueshme për periudhat nga fillimi ose pas datës 1 janar 2017 dhe të cilat Shoqëria nuk i ka implementuar përpara kësaj date.

***SNRF 9, "Instrumentet financiare" (lëshuar në korrik 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018).*** Pikat kryesore të standardit janë:

Aktivet financiare duhet të klasifikohen në tre kategori matjeje: aktive të matura më pas me kosto të amortizueshme, aktve të matura më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI), dhe ato të matura më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet fitim humbjes (FVPL).

- Sqarimi i intrumenteve të huasë bazohet nga modeli i biznesit së njësisë në manaxhimin e aktiveve financiare dhe sipas faktit nëse flukset monetare kontraktuale rrjedhin kryesisht nga pagesat e interesit dhe primit (SPPI). Nëse një instrument huaje është mbajtur për mbledhje, mund të mbartet me kosto të amortizuar nëse plotëson kushtet e pagesave të primit dhe interesave. Instrumentat e huasë që përmbushin këto kushte mbahen në një portofol ku një njësi mban dhe mbledh flukset monetare nga aktive dhe shet aktive që mund të klasifikohen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit apo humbjes. Aktivet financiare që nuk përmbajnë pagesa për interesa apo prime duhet të maten me vlerën e drejtë në fitim apo humbje (për shembull, derivativë). Derivativët e përfshirë nuk janë më të ndarë nga aktivet financiare por do të përfshihen në vlerësimin e kushteve të pagesave të primit dhe interesave.
